



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 26, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4529 Prot., datë 14.08.2023, në bazë të të dhënave statistikore ardhur nga gjykatat për periudhën 01.01.2022 - 10.08.2023 referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Sarandë, Shkodër, Tiranë, Fier, Vlorë si dhe pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nuk rezulton asnjë vendim i dhënë nga këto gjykata me anë të së cilës është vendosur deklarimi fajtor i ndonjë të pandehuri për kryerjen e veprës penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo në ankande publike” të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, për periudhën e kërkuar nga ana juaj.

Ndërsa në **Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** janë dhënë 7 vendime fajësie për veprën “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo në ankande publike” të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal dhe numri në total i të të dënuarve është 27 (njëzet e shtatë) si më poshtë:

1. Vendimi nr. 1, datë 11.01.2022; (1 i dënuar)
2. Vendimi nr. 24, datë 05.04.2022; (1 i dënuar)
3. Vendimi nr. 34, datë 26.05.2022; (3 të dënuar)
4. Vendimi nr. 41, datë 16.06.2022; (5 të dënuar)
5. Vendimi nr. 47, datë 29.07.2022; (12 të dënuar)
6. Vendimi nr. 4, datë 13.01.2023; (4 të dënuar)
7. Vendimi nr. 33, datë 12.05.2023. (1 i dënuar)

Ndërkohë ju informojmë se nuk ka pasur ish-funksionar të lartë publik të dënuar në lidhje me këtë vepër penale.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, në **Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** janë dhënë 10 vendime fajësie për veprën “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo në ankande publike” të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal dhe numri në total i të të dënuarve është 51 (pesëdhjetë e një) si më poshtë:

1. Vendimi nr. 34, datë 29.07.2022; (3 të dënuar)
2. Vendimi nr. 35, datë 08.09.2022; (1 i dënuar)
3. Vendimi nr. 37, datë 21.09.2022; (10 të dënuar)
4. Vendimi nr. 40, datë 26.09.2022; (1 i dënuar)
5. Vendimi nr. 47, datë 21.10.2022; (3 të dënuar)
6. Vendimi nr. 55, datë 07.12.2022; (5 të dënuar)
7. Vendimi nr. 56, datë 07.12.2022; (4 të dënuar)
8. Vendimi nr. 1, datë 04.01.2023; (6 të dënuar)
9. Vendimi nr. 13, datë 01.03.2023; (14 të dënuar)
10. Vendimi nr. 35, datë 31.07.2023. (4 të dënuar)

Ndërkohë ju informojmë se rezulton 1 (një) vendim fajësie për veprën “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo në ankande publike” të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal për ish-funksionarin e lartë publik, z. {...}.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!